REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ -MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 04-104/02-36922/26
Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.
Data / Datum / Date 17.11.2026
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Datë/Data/Date	***17.11.2026***
Për/Za/To	**Sami Ahmeti, Kryesues i Kuvendit Komunal, Obiliq**
Përmes	***Besnik Krasniqi – Drejtor i* DEFZH-s**
Nga/Od/From	**Besnik *Salihu-Kryesues i grupit punues për hartimin e Strategjisë Socio-Ekonomike të Komunes 2027-2030***
Tema/Subjekat/Subjeckt:	**Kërkesë për vënje në debat publik**

I nderuar Kryesues i Kuvendit, z. Sami Ahmeti,

Ju drejtohem me këtë kërkesë që në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të shqyrtohet vënja në debat publik i Draftit të parë të Strategjisë Socio-Ekonomike 2027–2030.

Kërkoj nga ju që kjo çështje të procedohet për shqyrtim në KPF dhe të rekomandohet për miratim në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal, me qëllim të caktimit të datave për mbajtjen e dëgjimeve publike.

Kjo do t'i mundësojë grupit punues vazhdimin e aktiviteteve dhe përfshirjen e rekomandimeve dhe propozimeve të qytetarëve, me qëllim të hartimit të draftit përfundimtar të Strategjisë Socio-Ekonomike 2027–2030.

Me respekt,

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Obiliqit
Opština Obiliq –Municipality of Obiliq

DRAFT – STRATEGJIA SOCIO-EKONOMIKE E KOMUNËS SË OBILIQIT 2027–2030

Komuna e Obiliqit

Strategjia Socio-Ekonomike 2027–2030

Periudha e zbatimit: 1 janar 2027 – 31 dhjetor 2030

HYRJA DHE QËLLIMI I STRATEGJISË SOCIO-EKONOMIKE TË KOMUNËS SË OBILIQIT 2027–2030

1. Hyrja

Strategjia Socio-Ekonomike e Komunës së Obiliqit për periudhën 2027–2030 është dokument strategjik që synon të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të komunës, duke identifikuar nevojat, sfidat, mundësitë dhe prioritetet për zhvillim të qëndrueshëm në katërvjeçarin e ardhshëm.

Hartimi i kësaj strategjie mbështetet në nevojën për planifikim të koordinuar të politikave dhe investimeve komunale, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve, zhvillimit të ekonomisë lokale, rritjes së punësimit, përmirësimit të shërbimeve publike dhe krijimit të kushteve më të favorshme për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Komuna e Obiliqit përballet me sfida dhe mundësi të veçanta që lidhen me zhvillimin ekonomik, potencialin industrial dhe energjetik, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e infrastrukturës, përkrahjen e bujqësisë dhe përmirësimin e shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Për këtë arsye, është e rëndësishme që zhvillimi komunal të planifikohet në mënyrë të integruar, duke harmonizuar objektivat ekonomike me nevojat sociale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Strategjia do të shërbejë si instrument orientues për institucionet komunale në përcaktimin e prioriteteve, planifikimin e projekteve dhe shpërndarjen efikase të burimeve financiare dhe njerëzore. Njëkohësisht, ajo synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet komunës, institucioneve qendrore, sektorit privat, shoqërisë civile, organizatave joqeveritare dhe qytetarëve.

Hartimi dhe zbatimi i strategjisë duhet të sigurojë lidhjen ndërmjet objektivave strategjike, Kornizës Afatmesme Buxhetore, buxheteve vjetore komunale dhe programeve të investimeve publike, në mënyrë që prioritetet e përcaktuara të përkthehen në masa konkrete, projekte të realizueshme dhe rezultate të matshme.

Strategjia Socio-Ekonomike 2027–2030 duhet të jetë në përputhje me dokumentet relevante të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit lokal, përfshirë Planin Zhvillimor Komunal 2027–2030, si dhe me politikat dhe dokumentet përkatëse në fuqi në nivel qendror dhe lokal.

Qëllimi i strategjisë

Qëllimi kryesor i Strategjisë Socio-Ekonomike të Komunës së Obiliqit për periudhën 2027–2030 është krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, përmirësim të mirëqenies sociale dhe rritje të cilësisë së jetës së qytetarëve, përmes planifikimit të integruar, shfrytëzimit efikas të burimeve dhe realizimit të investimeve prioritare komunale.

Vizioni : Obiliqi të zhvillohet si komunë me ekonomi lokale më të qëndrueshme, mundësi më të mëdha punësimi, shërbime publike cilësore, infrastrukturë funksionale, mjedis të përmirësuar dhe administratë transparente e efikase.

Misioni : Të planifikojë dhe të koordinojë zhvillimin socio-ekonomik përmes përdorimit efikas të burimeve komunale, bashkëpunimit me institucionet qendrore, sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët.

Objektivat strategjike për periudhën 2027–2030

Propozohen Shtatë objektiva strategjike, të cilat duhet të harmonizohen me dokumentet ekzistuese komunale dhe të miratohen pas konsultimeve.

Objektivi 1 – Zhvillimi ekonomik dhe punësimi
Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e bizneseve, ndërmarrësisë , investimeve , duke bashkëpunuar me sektorin privat dhe krijimin e mundësive të reja të punësimit.
Objektivi 2 – Arsimi, dhe aftësimi profesional
Përmirësimi i kushteve në institucionet arsimore, mbështetja e rinisë dhe zhvillimi i aftësive që lidhen me nevojat e tregut të punës
Objektivi 3 – Shëndetësia dhe përfshirja sociale
Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore dhe sociale, me vëmendje të veçantë ndaj familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara.
Objektivi 4 – Zhvillimi i bujqësisë
Rritja e kapaciteteve prodhuese dhe përkrahja e fermerëve përmes programeve të subvencionimit, këshillimit dhe përmirësimit të infrastrukturës bujqësore.
Objektivi 5 – Infrastruktura dhe shërbimet publike
Zhvillimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit, ndriçimit publik dhe hapësirave të përbashkëta, sipas kompetencave dhe prioriteteve komunale.
Objektivi 6 – Mbrojtja e mjedisit
Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, zgjerimi i hapësirave të gjelbra dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore.
Objektivi 7 – Rritja e transparencës, digjitalizimi i shërbimeve dhe përfshirja e qytetarëve në identifikimin dhe përcaktimin e prioriteteve zhvillimore.

Analiza socio-ekonomike
Analiza përfundimtare duhet të përgatitet duke u bazuar në të dhëna të verifikuara. Në këtë fazë, identifikohen fushat kryesore që duhen analizuar, pa supozuar se të gjitha problemet e përmendura janë të konfirmuara.

Fusha	Çështjet që duhet të analizohen	Burimi i të dhënave
Ekonomia dhe bizneset	Bizneset aktive, sektorët ekonomikë, investimet dhe punësimi	Drejtoria për Ekonomi dhe Financa-Sektori për Ekonomi
Arsimi	Gjendja e shkollave, infrastruktura dhe nevojat për pajisje	Drejtoria e Arsimit
Shëndetësia	Kapacitetet shëndetësore dhe qasja në shërbime	Drejtoria e Shëndetësisë
Bujqësia	Fermat, prodhimi, subvencionet dhe potenciali bujqësor	Drejtoria e Bujqësisë
Infrastruktura	Rrugët, kanalizimi, ujësjellësi, ndriçimi dhe hapësirat publike	Drejtoritë përkatëse-Infrastruktura Rrugore, Infrastruktura Publike
Mjedisi	Cilësia e ajrit, mbeturinat, gjelbërimi dhe ndotja	Drejtoria e Mjedisit
Qeverisja	Transparenca, performanca komunale dhe pjesëmarrja qytetare	Raportet komunale dhe raportet e performancës